



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:076228

Datë: 06.08.2019

Numri i dokumentit: 00446411

P.nr.255/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Haime Nixha në lëndën penale kundër të pandehurit A.B nga ..., me numër personal ..., për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185/1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren - Departamenti i përgjithshëm nr. PP/II.nr.391-7/19, të datës 27.02.2019 në praninë e Prokurorit të Shtetit Atnor Skoro të pandehurit A.B, me datë 06.08.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

A.B i lindur më ..., me numër ..., i biri i J.B dhe nënës A. B., e gjinisë, me vendbanim në fsh. , ... , ka të kryer shkollën e mesme të martuar babe i ... femive, i gjendjes së dobët ekonomike shqiptar shtetas i R. të Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 16.02.2019, rreth orës 17,00 në fsh.... seriozisht e kanos të dëmtuarin O.B me qëllim të frikësimit ose të shkakutimit të ankthit në atë mënyrë që derisa zyrtaret policore ishin njoftuar nga i dëmtuari në lidhje me një ndriçim publik i cili ndriçon rrugën në lagje ku ka qene i vendosur një shtylle nga e cila ishte larguar poqi elektrik e që ishte larguar nga ana e të pandehurit A., derisa zyrtaret policore shkojnë në vend të ngjarjes ku në atë moment kishte ardhur edhe i pandehuri i revoltuar i cili tenton të hynë në shtëpinë e të dëmtuarit ku ndalohej nga zyrtaret policore i pandehuri në prezencën e zyrtareve policore e kanos të dëmtuarin me fjalët: “kur ta krye me policinë kam për të mbyte” me qaras të i pandehuri dhe fmailjaret e tij shkakton frikë ankth dhe pasiguri.

-këso dore ka kryer veprën penale kanosje nga neni 185 par.1 të KP.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 49, 50 51 dhe 52 të KP të akuzuarit i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Me burg ne kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj i cili dënimi nuk do të ekzekutohet ne afatin prej 1 (nje) viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen veprën te re penale.

Te akuzuarit koha e kaluar ne paraburgim prej dt.16.02.2019 deri me dt. 22.02.2019 do ti llogaritet ne rast te revokimit te dënimit me kusht.

I dëmtuari O.B nga fsh. ... Komuna e Prizrenit, per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

Obligohet i pandehuri qe ti paguajë te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato behën ne baze te llogarisë se gjykatës, ne emër te te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcënim te ekzekutimit te dhunshëm.

Ne zbatim te ligjit mbi mbrojtjen e viktimave te krimit te akuzuarit i caktohet taksa ne lartësi prej 30 euro te cilën është i obliguar ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzën PP/II.nr.391-7/19 , të datës 27.02.2019 ndaj te akuzuarit A.B nga fsh. ... Komuna e Prizrenit , për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185/1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

I pandehuri A.B në shqyrtim fillestar në tërsi e ka pranuar veprën penale e cila i vebet në barrë sipas aktakuzës, e po ashtu ka pranuar edhe fajësinë .

Gjyqtari gjykues konstatoi se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 i KPP-së, nga se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajit, pranimi është i vullnetshëm dhe i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, andaj me aktvendim pranoi pranimin e fajësisë.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit , plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale te kanosjes nga neni 185/1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës , prandaj dhe ia shqiptoi dënimin me kusht , duke qenë i bindur se me këtë lloj dënimi do te arrihet qëllimi i të njëjtit.

Me rastin e shqiptimit të dënimit kjo gjykate pati parasysh si rrethana lehtësuese per të akuzuarin , pranimin e fajësisë , premtimin se në të ardhmen nuk do te kryej me vepra penale, si dhe sjelljen korrekte para gjykatës, dhe se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është mare ne kuptim te nenit 450 dhe 452 të KPPK-se.

Vendimi mbi udhëzimin ne kontest civil u mur ne kuptim te nenit 463 par.2 te KP.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2019:076228, 06.08.2019

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.